



TRAKT KUNDER TRADHTISE

(Lexoje dhe dergojua atyre qe ky trakt do beje t'i vene gishtin kokes)

Njer i poshtër asht tradhtari,
fyturë as faqe n'vete s'ka;
as mizori, as barbari
para tij nuk janë kurrë!
Hil MOSI

Eshtë në natyrën e egër e dinake të çdo pushtuesi, që qëllimet e veta ekspansioniste e kriminale t'i mbulojë përmes ndonjërit prej banorëve të vendit të pushtuar dhe, zakonisht, krahas zingjirëve (mundësisht sa më të trashë), bajonetave, plumbit, zjarrit e dajakut, sjell me vete edhe buzqeshjen me fjalët e domosdoshme se aty ka ardhur si çlirues! Dhe nuk lë mënyrë e mjet pa përdorë për t'i bindë të pushtuarit se aty ka ardhur për gjithnjë dhe se nuk do të ketë forcë në botë që ta shporrë! Kështu thonin, vepronin e mendonin dje turqit në Ballkan apo amerikanët në Vietnam, të njëjtën gjë e bëjnë sot rusët në Afganistan, ashtu siç thonë, mendojnë e veprojnë edhe sot e gjithë ditën serbojugosllavët në Kosovë. Të gjithë pushtuesit kanë një fyturë dhe, pa përjashtim, për t'i arritur qëllimet e veta shërbehen me metoda të njëjta: përmes lajkave, ofiqeve, parave, shantazhit, torturave frikësimeve etj., formojnë rreth vetës një paravan tradhtarësh, bastardhësh e renegatësh, në emrin e të cilëve pastaj djegin, vrasin, masakrojnë, burgosin, shfrytëzojnë e dënojnë. Edhe këto vegla të fëlliqura, këta shpirtshitur që ia fusin pabesisht në kurriz thikën e neshtër Popullit e Atdheut, në veprimet e veta të poshtra shërbehen me fjalë të mëdha se ketë e bëjnë nga patriotizmi i tyre i kulluar, nga qëllimet më të pastra, apo, siç tha një ditë, në një ndejë shpirtshituri Fadil Hoxha: «...sikur të mos isha unë do t'ua bënin edhe më zi!» Edhe tradhtia pra, e ka fjalorin, veshjen, maskat dhe modën e vet, no përkundër të gjithave nuk mund t'i fshihë kurrë gjurmët, sepse, sipas një ligji të pashkruar, ajo nuk mbetet kurrë e pazbuluar. Tradhtia më shumë se asgjë tjetër lë gjurmë e vërragë të thella që s'mund t'i mbulojë për jetë as bora, as shiu, as koha. Gjurmët e tradhtisë e të gjakut kanë një konstancë absolute.

Ashtu si dikur pashallarët me origjinë shqiptare, si Ballaban Pasha me shokë, që e mbulonin me gjak shtatin e shenjtë të Arbërisë, që i pat lindë e rritë, ashtu si Esat Toptani që ua lëshoi Shkodrën malazezëve, ashtu si Ceno Kryeziu e Ahmet Zogu me Musa Jukën e fëlliqur që tradhtuan interesat e Atdheut, bënë pazarllëqe me tokat e tij, erdhën në pushtet me ndihmen e armiqve shekullorë, e luftuan me të gjitha mjetet Komitetin e Kosovës, i vrane e i syrgjynosën ideologët kryesorë të tij etj., poashtu edhe sot, mjerisht ka bastardë e kuizlingë të tillë, të cilët shqiptari i sheh në surratin e neveritshëm të Ali Shukriut, Fadil Hoxhës, Sinan Hasanit, Mehmet Maliqit, Rrahman Morinës, Xhemail Veselit, Hysen Ramadanit, Azem Vllasit e të tjerëve, që s'po ua zëmë në gojë emrin jo pse nuk e meritojnë, por pse po e lëmë për më vonë. Veç këtyre që përmendem, kush sot hyn, në mënyrë të përgjithësuar në kategorinë e tradhtarëve?

Tradhtar e i shitur është ai që ka ngjyer duart me gjakun e shenjtë të popullit, ai që aprovon krimet jugosllave në kurriz të shqiptarit, ai që në ditë i ndërron 100 fytyra dhe rri apo silltet në oborre shkollash e fakultetesh, në stacione autobusi a treni, në treg, në shitore, në kishë, në xhami, në oda, në stadion e kudo tjetër dhe me sytë e veshët e tij satanikë pëpiqet të shohë e të dëgjojë edhe përshpëritjet më intime të njerëzve, ai Judë e shkuar Judës që i mbush sefat e udbës me informata kundër popullit të vet, ai që është kthyer në dajakxhi të popullit që e ka lindë e rritë, ai kasap që i udhëhequr nga udbashë-pushtues serbë torturon dhe masakron vëllan e tij të gjakut; tradhtar e gjakpirës është ai iblis që infiltron në radhët e Lëvizjes dhe pëpiqet t'ia përjetësojë prangat e robërisë popullit t'onë të shtypur, i njëjtë është edhe ai hor i fëlliqur që për një fotele të poshtër dënon njëzë dhe fëmijë të pafajshëm apo që e mban në burg me nga 30 vjet Adem Demaçin me shokë; tradhtar është ai mësimdhënës që spiunon nxënësin e vet, apo ai profesor që kërcënon e denoncon studentët e tij, ai shkencëtar që përdhosë historinë e kombit të vet, apo ai që nuk i nxjerr në dritë padrejtësitë e shumta që i janë bërë Kosovës, tradhtar e zuzar është edhe ai letërnxirës që në paqavuret jugosllave shet për tre dinar nderin e vet dhe gënjen, fyen e mashtron popullin e tij; tradhtar e hijenë e ndyrë është edhe ai që maskohet me buzqeshjen e miqësisë për të spiunuar më lehtë dhe për ta denoncuar te armiku edhe vëllanë, edhe shokun, edhe fqinun edhe mikun; tradhtar e qelbanik është ai që denoncon luftëtarët e lirisë, ashtu si edhe ai që del para gjyqit dhe për një grusht parash të mjera dëshmon kundër bijve të popullit.

Tradhtarë e armiq janë ata hora që në mërgim i spiunojnë mërgimtarët patriotë, ai që në kurriz të këtyre njerëzve të varfër, që kanë lënë fëmijë e shtëpi për një kafshatë buk, pëpiqet të fitojë para e kolltuk është gjarper mbi gjarperun dhe fundi i tij do të jetë i njëjtë me të atyre «diplomatëve» «shqiptarë», që përgatisin kurthe e atentate kundër djalërisë kosovare që ka ikur nga dhuna e terrori serbo-shovinist dhe tash i duhet ta bëjë jetën e mjerë e të hidhur të kurbetit, pra sidomos këta gjithsesi do të përfundojnë nga plumbi i zotrinjve

të vet, të cilët për t'i fshehë gjurmët e tyre të përgjakshme së pari do t'i qërojnë mashat e e veta të fëlliqura. E pabesë e tinëzare është ajo mërgatë qyqesh e bretkocash, që i ka ndër-ruar me dhjetra zotrinj e flamuj dhe tash në emër të njëfarë «patriotizmi» të vet përpiqet ta minojë aktivitetin revolucionar të atdhetarëve tanë jashtë. Armiq e tradhtar nga më të rrezi-kshmit janë të gjithë ata që Lëvizjen tonë sokoleshë në mënyrat më perfide përpiqen ta lid-hin për bishtin e cilitdo shërbim informativ qoftë (një organizatë nacionalçlirimtare siç është Lëvizja jonë, po qe se nuk qëndron apsolutisht e pavarur, ajo që në hapat e parë do ta tradhtojë vetën, pra do ta përdhosë qëllimin e vet fisnik), aspak më të mirë nuk janë as ata megalomanë e hipokritë që krekosën me punën e tjetrit, ata që zbukurohen me petkun e huaj dhe që me dallavere, shpifje e thashetheme përpiqen ta mbulojnë injorancën, cektësinë intelektuale dhe inaktivitetin e tyre; në një thes me ta duhet futur edhe ata, që me vetëdije ose pa të përpiqen që nga lumi rrëmbimtar i Lëvizjes ta ndajnë qoftë edhe një pikë të vetme uji çlirimtar; armiq e shpirtkalbur janë edhe ata qorra që sot e sulmojnë RPS të Shqipërisë atdheun e dashur të të gjithë shqiptarëve. Armiq e tradhtarë janë ato marimanga të fëlliqu-ra, që kudo që shkojnë endin rrjetën e tyre helmuese (në të cilën zakonisht bien vetëm nai-vët), mbjellin kudo farën e dyshimit dhe fusin poashtu kudo që të munden pykat e përça-rjes.

Të gjitha këto lloje e tipe qelbanikësh, ashtu si edhe ata kapitulantë që janë futur në biru-cën e individualizmit dhe gënjejnë botën se po presin ditë më të mira, hynë komplet në ga-lerinë e plehrave të historisë, dikush më poshtë e dikush më lartë, po në instancë të fundit të gjithë mbetën: plehra.

E kundërta e tërë kësaj zoologjie satanike e qyqare është atdhedashuria, kjo ndjenjë fisnike mbi të gjitha ndjenjat, ndërsa luftëtarët e lirisë si antipodë të së keqes, janë bijtë-sokolat e një populli, që me gjoksin, zemrën e tyre të madhe dhe me mendjen largpamëse e çajnë his-torinë duke i hapur popullit të vet shtigje të reja drejt lirisë, pavarësisë e lumturisë. Luftëta-rin e lirisë nuk ka forcë që e then as para që e blen, ai nuk i përkulet e nuk i gjunjëzohet kurrë as lajkës, as kolltukut, as famës, as parasë, as vdekjes, as tabusë; ai ka vetëm një Perë-ndi: Popullin-Atdheun, liria e të cilit është ideal, gjakim, qëllim i vetëm e më i lartë në gjit-hë jetën e tij.

Në një kohë heroike, siç është kjo jona, këngëtari i këngëtarëve, poeti i paarritshëm-popull i ka kënduar lirisë dhe luftëtarëve të saj, por s'e ka harruar as tradhtinë:

N'kam janë çue krejt hafja,
kta hafija nom po hajnë,
ni burrë t' mirë kun s'po e lanë...
Azem Bejta ni burre azgan,
ksaj hafijes çka i kish thanë:
kit punë t'keqe ju me lanë,
se n'kofsha ai që jam kanë
për atë dynje kuj s'kam m'ja lanë!
Azem Bejta trim he medet,
kuj s'ja lejke për ahret,
këta hafijet po i hjek vet,
boll shumë njerzit n'men i ka pru,
shumë me pushkë ma shumë me dru!

Nga këto vargje duhet të mësojnë, dhe të jenë të sigurt se i pret i njëjti fat, të gjithë ata që s'e kanë ndër-jegjen e pastër: ata që kanë lënë nëna me duar në gjinj, ata dinakë që kanë kafshuar si kobra, ata që kanë shitur vëllanë e vet për një armë, për një rrogë, për një kolltuk, për një rrahjekrahësh regjimi, për një pasaport, për një dekoratë serbe; ata që kanë nxjerrë sy e kanë shkyer zemra si korba... Në kohën tonë më shumë se kurrë ka fatosa që do ta çli-rojnë popullin nga qelbësira të tilla. Kosova sot është përplot Avni Rrustema e Azem Gali-ca, dhe këtë duhet ta kenë parasysh mirë të gjithë protagonistët e këtij trakti.

Në fund, të gjithë të mashtruarve, LRSNJ u bën thirrje që të largohen nga rruga e fëlliqur e tradhtisë, sepse pas kaq lumenjve të gjakut që dergji Jugosllavia fashiste nga trupi e zemra e shqiptarit, qoftë edhe tradhtinë më të vogël populli nuk do t'ia falë më kujt. Njëherit Lëvi-zja u bën thirrje të gjithë shqiptarëve që punojnë në pushtetin e sotëm jugosllav, që ta kry-ejnë obligimin patriotik ndaj popullit e atdheut, dhe ta rrëmihin armikun nga brenda duke e informuar Lëvizjen për planet dhe veprimet e tij, duke dërguar informata për të gjitha ato që ka bërë dje apo që bën sot regjimi gjakatar jugosllav kundër popullit tonë! Ju policë shqiptarë, që keni veshur uniformën e urryer të armikut, vazhdoni traditat e pranverës së përgjakshme të 1981-shit, kur mahnitët botën me qëndrimin tuaj patriotik, sepse populli nuk do t'ua harrojë kurrë, si të mirën, si të keqen ai e mban gjithmonë në shpirt!

Lavdi atyre që për Popull e për Atdhe nuk kursejnë asgjë!

Lavdi e përjetshme atyre që ia dhanë e ia japin tradhtisë dënimin e merituar!

Rroftë populli heroik e i pamposhtur shqiptar!

Poshtë mizorja dhe e fëlliqura tradhti!

LEVIZJA PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI